

LIGJ
Nr.8301, datë 12.3.1998

PËR NDRYSHIMIN E TAKSAVE DOGANORE PËR DISA INPUTE BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në emërtesën e mallrave taksat doganore për inputet bujqësore sipas kreut 07.01 dhe kodit 0701.10 (farë patate); kreut 10.01 (farë gruri); kreut 10.05 dhe kodit 1005.10 (farë misri); kreut 12.06 dhe kodit 1206.00 (farë luledielli); kreut 12.09 (farat, frutat dhe sporet, të një lloji të përdorur për mbjellje); krerëve 31.01; 31.02; 31.03; 31.04 dhe 31.05 (plehërat) ndryshohen nga 10 për qind në 5 për qind; kurse taksat doganore sipas kreut 38.08; kreut 39.20 dhe kodit 3920.20 (fletë plastmasi për mbulesa sere) ndryshohen nga 20 për qind në 5 për qind.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2030, datë 1.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani